

Njoftimi i përqendrimit me të cilin Shoqëria Pensionale Universale Generali SH.A. Poloni do të fitoj kontrollin mbi Fondin Pensional të Hapur MetLife, Poloni dhe Fondin Pensional Vullnetar MetLife Poloni

(lënda nr. 08-127)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 28 shtator 2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim i përqendrimit me të cilin **Shoqëria pensionale universale Generali SH.A. (Generali Powszechna Towarzystwo Emerytalne S.A)**, me seli në Varshavë në rr. Senatori nr. 18, 00-082 Varshavë, Poloni, synon të fitoj drejtpërdrejt kontrollin e vetëm mbi **Fondin Pensional të Hapur MetLife (MetLife Otwarty Fundusz Emerytalny)** dhe **Fondin Pensional Vullnetar MetLife (MetLife Dobrowolny Fundusz Emerytalny)**, me seli në Varshavë në rr. Przemyslowa 26, 00-450 Varshavë, Poloni.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

Shoqëria Pensionale Universale Generali SH.A., është në pronësi dhe kontroll të tërthortë nga Asiguracioni Xhenerali S.p.A., Itali (Assicurazioni Generali S.p.A., Itali), shoqëri mëmë e grupit ndërkombëtar të shoqërive aktive në sektorin e sigurimeve dhe financave - Generali Group. Parashtruesi Njoftimit menaxhon me biznesin e Generali në Poloni.

Generali Group ka një ndërmarrje-bijë në Maqedoninë e Veriut – shoqërinë Generali Investments AD Skopje, me seli në Bul. Partizanski Odredi 14A-1/2, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut.

Fondi Pensional i Hapur MetLife është një fond pensioni i hapur polak i menaxhuar nga Shoqëria Pensionale Universale MetLajf dhe i njëjti nuk ka ndërmarrje-bijë, filiale ose përfaqësi në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka realizuar asnjë qarkullim në Maqedoninë e Veriut në 2019, 2020 dhe 2021.

Fondi Pensional Vullnetar MetLife është një fond pensioni vullnetar polak i menaxhuar nga Shoqëria Pensionale Universale MetLife. MetLife DPF nuk ka ndërmarrje-bijë, filiale ose përfaqësi në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka realizuar asnjë qarkullim në Maqedoninë e Veriut në 2019, 2020 dhe 2021.

Sipas parashtruesit të njoftimit, treg relevant që i referohet përqendrimit është sektori i sigurimeve, më konkretisht fondet e pensioneve.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

30.09.2022

Shkup

